



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

---



**Leje Ndërtimore**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-7493

Dt.10.01.2025.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

**VENDIM**  
**(për Leje Ndërtimore)**

**Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:**

Emri:	LIRIDONI SH.P.K. me NUI 811404962, me seli ne Raushiq – INVESTITORI dhe shfrytëzues bazuar në aktin noterial – Kontratë për Qiranë e Paluajtshmërisë, me nr. I LRP-së, 13293/2021, nr. I ref & origj.3111/2021, dt. 29.10.2021.		
Adresa:	Magjistranja Pejë –Deqan, km 2 – Raushiq - Pejë		
Telefoni:	048 234 231 Nita Krasniqi	Emaili:	nita.krasniqi@sunvolta-ks.com

Emri i Projektit:	Ndërtimi i montimi i paneleve të Energjisë diellore, me kapacitet 100 kW, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 6917 i datës 17.05.2024, në objektin afarist ekzistues, i cili posedon me Lejen Ndërtimore – Vendimi me nr. 07/351/02-24577, dt. 21.02.2023, lëshuar nga DUMM.		
Emri i Projektuesit:	“SunVolta Energy” SH.P.K.” Prishtinë nui 810053819.		
Adresa:	Rruga “Eqrem Qabej” nr. 104-1 Prishtinë.		
Telefoni:		Emaili:	

**Për punët ndërtimore në vijim:**

Adresa: **Rruga “Dëshmorët e Herqetit”**

Zona(t) Kadastrale: **Jahoc**

Nr. i parcelave kadastrale: **600-2, 601-0**

GPS Koordinatat:

**Lloji i ndërtimit të propozuar:**

Ndërtim i ri  Rindërtim  Riparim

**Kategoria e ndërtimeve të propozuara:**

Kategoria I  Kategoria II

**Përdorimi i propozuar:**

A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po  Jo

**Përshkrimi: Lejohet Ndërtimi paneleve të Energjisë diellore, me kapacitet 100 kW, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 6917 i datës 17.05.2024, në objektin afarist ekzistues, i cili posedon me Lejen Ndërtimore – Vendimi me nr. 07/351/02-24577, dt. 21.02.2023, lëshuar nga DUMM.**

- **Obligohet pala qe pas pranimit te Lejes Ndërtimore – Instalimit te paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me te njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.**

Me këtë vendim, **LIRIDONI SH.P.K. me NUI 811404962, me seli ne Raushiq – INVESTITORI dhe shfrytëzues bazuar në aktin noterial – Kontratë për Qiranë e Paluajtshmërisë, me nr. I LRP-së, 13293/2021, nr. I ref & origj.3111/2021, dt. 29.10.2021** i lejohet Ndërtimi paneleve të Energjisë diellore, me kapacitet 100 kW, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 6917 i datës 17.05.2024, në objektin afarist ekzistues, i cili posedon me Lejen Ndërtimore – Vendimi me nr. 07/351/02-24577, dt. 21.02.2023, lëshuar nga DUMM dhe njëkohësisht obligohet pala qe pas pranimit te Lejes Ndërtimore –Instalimit te paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me te njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.

#### **Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë se saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese ne vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
  - informata mbi Lejen Ndërtimore
  - informatat mbi projektuesin
  - informata mbi kontraktuesin
  - prezantimi grafik i dukjes se ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
  - projektin kryesor me te gjitha faza për nevoja te realizimit te ndërtimit;
  - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - protokollat e miratuara te nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
  - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor te miratuara nga projektuesi përveç në rastet kur:
    - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike ne fuqi;
    - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero pjesje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
    - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
    - o Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.



# Ar sy e t i m

Aplikuesi – **LIRIDONI SH.P.K. me NUI 811404962, me seli ne Raushiq – INVESTITORI dhe shfrytëzues bazuar në aktin noterial – Kontratë për Qiranë e Paluajtshmërisë, me nr. I LRP-së, 13293/2021, nr. I ref & origj.3111/2021, dt. 29.10.2021,** përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-7493 të datës dt.15.05.2024 të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për Ndërtimi paneleve të Energjisë diellore, me kapacitet 100 kW, konform Pëlqimit nga KEDS nr. 6917 i datës 17.05.2024, në objektin afarist ekzistues, i cili posedon me Lejen Ndërtimore – Vendimi me nr. 07/351/02-24577, dt. 21.02.2023, lëshuar nga DUMM, në parcelat me nr. 600-2, 601-0 ZK: Jahoc, në pronësi të Blurim (Shaban) Mehmetaj nga Gjakova.

DUMM, përkatësisht zyrtari përgjegjës për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt.20.03.2023.
- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronësi të paluajtshme (fotokopje) me numër në pronësi të Blurim (Shaban) Mehmetaj nga Gjakova të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Lejen Ndërtimore – Vendimi me nr. 07/351/02-24577, dt. 21.02.2023, lëshuar nga DUMM.
- Lejen Mjedisore Komunale me nr. 07/351/02-15203, dt. 14.11.2024, lëshuar nga DUMM.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Autorizimin e legalizuar tek noteri me nr. LRP Nr. 5607/2024, dt. 25.04.2024.
- Pëlqimit Elektroenergjetik, nga KEDS nr. 6917 i datës 17.05.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga “SunVolta Energy” SH.P.K.” Prishtinë nui 810053819.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim.

Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t’i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Hartoi aktin

Zenel Shabani Z.L. Ligjor

Zyrtari përgjegjës për lëndë

Elida Bejtullahu I.D.A.



Drejtori

Arben Bakalli

